

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere, ndaj korrupsionit.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuere, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Nëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Tetor, 2021

Krijimi i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

20.10.2021. Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit tashmë do të ketë një strukturë të organizuar, të dedikuar dhe të specializuar me qëllim kryerjen e funksioneve të tij, në përputhje me VKM-në nr.618, datë 20.10.2021 "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit". Si pjesë e kësaj strukture në Ministrinë e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion do të ushtrorë kompetenca të fushës parandaluese – ndëshkuese – ndërgjegjësuere. Kjo strukturë do të drejtojë procesin e hartimit të politikave strategjike dhe kuadrit ligjor në fushën antikorrupsion; do të koordinojë zhvillimin e projekteve dhe programeve për zbatimin e kuadrit strategjik dhe ligjor në fushën antikorrupsion; si edhe do të jetë përgjegjëse për ushtrimin e kompetencave të kontrollit dhe të goditjes së korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore. Struktura do të përfaqësojë Koordinatorin Kombëtar dhe Qeverinë Shqiptare në angazhimet e tyre për luftën kundër korrupsionit.

VKM-ja e re është e aksesueshme në këtë link: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/10/20/618>



Miratimi i Raportit të Monitorimit të Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën Janar - Qershor 2021

25.10.2021. Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit miratoi Raportin Gjashtëmujor të Monitorimit për periudhën Janar-Qershor 2021, të Planit të Veprimit 2020-2023. Mbledhja e Komitetit Koordinator u drejtua nga Ministri i Drejtësisë, Z. Ulsi Manja, në prani të zëvendësministrave të ministrive të linjës, të ngarkuar me portofolin antikorrupsion. Raporti Gjashtëmujor jep informacion të detajuar mbi progresin e realizimit të masave, aktiviteteve dhe treguesve të performancës. Në raport gjithashtu evidentohen problematika në zbatimin e këtij plani veprimi, rekomandime, si edhe detyra për institucionet zbatuese të strategjisë. Për këtë periudhë zbatimi e monitorimi janë realizuar plotësisht 26 masa dhe 56 aktivitete, pjesërisht 24 masa dhe 22 aktivitete dhe nuk janë realizuar 11 masa dhe 28 aktivitete.

Raporti i Monitorimit Janar-Qershor, 2021 mund të aksesohet në këtë link: <https://www.drejtesia.gov.al/viti2021/>

Takim me institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, për prezantimin e Manualit për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Institucionet Qendrore

14.10.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e institucionit koordinues në procesin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit të Planeve të Integritetit në institucionet e saj të varësisë, në bashkëpunim me Projektin e Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian (AT DBE), organizoi një takim të dedikuar me të gjithë përfaqësuesit e këtyre institucioneve. Takimi u kryesua nga Zëvendësministrja e Drejtësisë, Znj. Adea Pirdeni. Në këtë takim u prezantua Manuali për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Institucionet Qendrore, i hartuar nga ekspertët e Projektit të AT DBE. Manuali është një sintezë e shkurtër dhe e qartë e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet Qendrore, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020. Gjatë takimit, eksperti i AT DBE bëri një prezantim të zgjeruar mbi të gjithë procesin e vlerësimit të riskut dhe hartimit të Planit të Integritetit. Manuali do t'i shërbejë institucioneve të varësisë për të strukturuar procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në institucion dhe për hartimin e Planeve efektive të Integritetit.

Ky manual do të mund të aksesohet në vijim në këtë link: <https://www.drejtesia.gov.al/instrumente-antikorrupsioni/>



Prezantimi për Shqipërinë i Raportit të OECD "Konkurrueshmëria në Vendet e Evropës Juglindore: Perspektivat Politike 2021"

18.10.2021. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD) organizoi takimin prezantues për Shqipërinë të Raportit "Konkurrueshmëria në Vendet e Evropës Juglindore: Perspektivat Politike 2021". Raporti është i organizuar në 16 dimensione, nëpërmjet të cilave vlerësohet aftësia konkurruese e secilit prej vendeve të rajonit. Në dimensionin e politikave antikorrupsion, për Shqipërinë raporti vlerëson veçanërisht fushën e parandalimit të korrupsionit. Në këtë fushë, Shqipëria ka marrë një vlerësim më të lartë se mesatarja e vendeve të rajonit, ku ka spikatur pozitivisht roli kyç i Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion në drejtim të planifikimit, koordinimit dhe monitorimit të politikave të fushës. Gjithashtu, është vlerësuar pozitivisht edhe prioriteti që Shqipëria i ka dhënë financimit nga buxheti i shtetit të aktiviteteve me karakter ndërgjegjësuere. Raporti përmban gjithashtu edhe rekomandime të përgjithshme për të rritur aftësinë konkurruese të vendit.

Raporti i OECD është i aksesueshëm në këtë link: <https://www.oecd.org/publications/competitiveness-in-south-east-europe-2021-dcbc2ea9-en.htm>

Cikli i trajnimeve me pikat e kontaktit antikorrupsion

26.10.2021. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Projektit të Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit dhe ASPA, filloi pjesën e dytë të ciklit të trajnimeve për pikat e kontaktit antikorrupsion. Objektivi kryesor i këtij cikli trajnimesh është forcimi i kapaciteteve për pikat e kontaktit antikorrupsion në institucionet e administratës publike. Kjo seancë trajnimi ishte e fokusuar në procesin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit të Planit të Integritetit për institucionet qendrore. Seanca kishte karakter ndër-aktiv dhe pjesëmarrësit u angazhuan drejtpërdrejt duke dhënë shembuj konkretë nga institucionet e tyre. Procesi i vlerësimit të riskut dhe hartimit të Planit të Integritetit për institucionet qendrore është prioritar dhe rekomandimet teknike të trajnerit në këtë seancë i shërbejnë pozitivisht këtij procesi.



Takime të posaçme me institucione përgjegjëse për implementimin e rekomandimeve të raundit të pestë të vlerësimit të GRECO

27.10.2021. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për koordinimin institucional të implementimit të rekomandimeve dhe raportimin në GRECO, pas monitorimit të ecurisë së deritanishme të këtij procesi, organizoi tre takime të posaçme me disa prej institucioneve përgjegjëse për rekomandimet e raundit të pestë të vlerësimit. Në këto takime, morën pjesë përfaqësues të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Kryeministrisë, Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit, Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Institucionet raportuan mbi ecurinë e zbatimit të masave të marra në kuadër të implementimit të rekomandimeve. Takimi i shërbeu diskutimit dhe dakordësimin për çështje teknike të procesit, si edhe për një kalendar konkret për takimet e ardhshme në funksion të bashkëpunimit ndër-institucional për implementimin me prioritet të këtyre rekomandimeve.

Takim me partnerët për edicionin e tretë të Javës së Integritetit

08.10.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, mori pjesë në takimin me partnerët e edicionit të tretë të Javës së Integritetit, të organizuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) në Tiranë. Java e Integritetit është një fushatë kombëtare me karakter ndërgjegjësuere, nëpërmjet të cilës synohet të promovohet kultura e integritetit në Shqipëri në të gjitha instancat publike dhe private. Edicioni i tretë i Javës së Integritetit do të zhvillohet në datat 1-10 Dhjetor, 2021. Objektivi i këtij takimi ishte planifikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi për organizimin e aktiviteteve të edicionit të tretë të kësaj jave. Në kuadër të këtij edicioni, Ministria e Drejtësisë do të organizojë dy forume respektive me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe komunitetin e biznesit. Këto forume do të kenë karakter informues dhe ndërgjegjësuere lidhur me ndryshimet e reja në kuadrin institucional antikorrupsion dhe mundësinë e kontributit të drejtpërdrejtë në luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet përdorimit të mekanizmave të reja.

